



Funded by
the European Union

unicef 
for every child



Transformimi i Arsimit në Kosovë me Pasaportën e të Nxënës:

Rasti i Shkollat.org

Përmbledhje e politikave

UNICEF INNOCENTI – ZYRA GLOBALE E HULUMTIMIT DHE PARASHIKIMIT

UNICEF Innocenti – Zyra Globale e Hulumtimit dhe Parashikimit trajton çështjet me rëndësi më të madhe për fëmijët, si aktuale ashtu edhe ato në zhvillim. Ai nxit ndryshimin përmes hulumtimit dhe largpamësisë mbi një gamë të gjerë çështjesh të të drejtave të fëmijëve, duke ndezur diskursin global dhe duke përfshirë aktivisht të rinjtë në punën e tij.

UNICEF Innocenti pajis udhëheqësit dhe vendimmarrësit me dëshmitë që u nevojiten për të ndërtuar një botë më të mirë dhe më të sigurt për fëmijët. Zyra ndërmer hulumtime për çështje të pazgjidhura dhe në zhvillim, duke përdorur të dhëna parësore dhe dytësore që përfaqësojnë zërat e vetë fëmijëve dhe familjeve. Ai përdor largpamësinë për të vendosur agjendën për fëmijët, duke përfshirë skanimin e horizontit, analizën dhe zhvillimin e trendeve. Zyra prodhon një bibliotekë të larmishme dhe dinamike të raporteve, analizave dhe dokumenteve të politikave të nivelit të lartë dhe ofron një platformë për debat dhe avokim mbi një gamë të gjerë çështjesh të të drejtave të fëmijëve.

UNICEF Innocenti ofron, për çdo fëmijë, përgjigje për shqetësimet e tyre.

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë punim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF-it.

Ky dokument është rishikuar si nga jashtë ashtu edhe brenda UNICEF-it.

Ekstrakte nga ky publikim mund të riprodhohen lirisht me njohjen e duhur. Kërkesat për të përdorur pjesë më të mëdha ose publikimin e plotë duhet t'i drejtohen Njësisë së Komunikimit në researchpublications@unicef.org.

Çdo pjesë e këtij publikimi mund të riprodhohet lirisht nëse shoqërohet me citimin e mëposhtëm: Transformimi i Arsimit në Kosovë me Pasaportën Mësimore. Rasti i Shkollat.org. UNICEF Innocenti – Zyra Globale e Hulumtimit dhe Parashikimit, 2023.

MIRËNJOHJE

Ky raport u përgatit nga Joaquín Cárceles Martínez-Lozano dhe Thomas Dreesen, nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e Matt Brossard, Shef i Arsimit, UNICEF Innocenti – Zyra Globale e Hulumtimit dhe Parashikimit.

Autorët vlerësojnë kontributet e paçmueshme gjatë gjithë hulumtimit nga kolegët e UNICEF-it në Kosovë (Nona Zicherman, Larissa Brunn, Kozeta Imami, Timur Ramiqi, Teuta Halimi dhe Antígona Uka), Zyra Rajonale e UNICEF-it për Evropën dhe Azinë Qendrore (Nora Shabani dhe Christina Siina) dhe Selia globale e UNICEF-it (Pragya Dewan). Ekipi hulumtues është gjithashtu mirënjohës për komentet e Marigona Morinës (Universiteti i Calgary) dhe Bardha Qirezit (EduTask), të cilët mbështetën procesin e rishikimit. Së fundi, ne i vlerësojmë veçanërisht kontributet dhe përpjekjet hulumtuese të kolegëve në Institutin e Psikologjisë – Universiteti i Prishtinës, të cilët udhëhoqën vlerësimin e nevojave që mbështet këtë përmbledhje të politikave (Diadora Cërmjani, Kaltrina Kelmendi, Linda Hoxha dhe Era Hamiti).

Korrespondenca duhet t'i drejtohet:

UNICEF Innocenti – Global Office of Research and Foresight
Via degli Alfani, 58
50121 Florence, Itali
Tel: (+39) 055 20 330
Fax: (+39) 055 2033 220
researchpublications@unicef.org
www.unicef-irc.org
@UNICEFInnocenti në Twitter, LinkedIn,
Facebook, Instagram dhe YouTube
© 2023 United Nations Children's Fund (UNICEF)
Cover photo: @UNICEF/2021/L.Aliu

Kjo përmbledhje e politikave u përgatit në kuadër të projektit 'Zbutja e ndikimit të COVID-19 tek fëmijët dhe familjet në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi', financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNICEF.

Materialet, përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë ato të ekspertëve të angazhuar në hulumtim dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Dizajni grafik: Small World Stories



PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Me zbatimin e duhur, të mësuarit digjital është një mjet i fuqishëm që mësuesit mund ta përdorin për t'u ofruar nxënësve mësim interaktiv, argëtues dhe të individualizuar, si brenda, ashtu edhe jashtë klasës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e Kosovës¹, ku në vitin 2018, katër nga pesë 15-vjeçar (79 përqind) kishin vështirësi që të kuptojnë një tekst me gjatësi dhe kompleksitet mesatar, një përqindje shumë më e lartë se mesatarja e Ballkanit Perëndimor (54 përqind) (OECD, 2020). Në Kosovë, të mësuarit digjital është ende një koncept relativisht i ri, i lidhur përgjithësisht me të mësuarit në distancë gjatë pandemisë COVID-19. Në këtë kontekst, duhet të bëhen përpjekje shtesë për të siguruar që mësuesit mund të përdorin të mësuarit digjital në mbarë Kosovën si mjet për të ofruar mësim me nxënësin në qendër, pavarësisht nëse mësimdhënia zhvillohet ballë për ballë apo në distancë. Kjo është reflektuar edhe në Strategjinë e Arsimit të Kosovës (2022–2026), ku digjitalizimi në arsim është përfshirë si një nga pesë objektivat kryesore strategjike. Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë dëshmi dhe mësim të nxjerra (ang. "takeaways") nga politikat për të forcuar të mësuarit digjital në Kosovë, me fokus në zgjerimin e përdorimit të platformës kombëtare të Kosovës për të mësuarit digjital: Shkollat.org.

Shkollat.org, versioni i lokalizuar i Pasaportës së të nxënësve², u lansua në vitin 2021 nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në bashkëpunim me UNICEF-in. Platforma e të mësuarit kombinon repositorin (depon) më të madhe të përmbajtjes mësimore në formë të videove të përshtatur me kurrikulën në Kosovë me mjetet e komunikimit si Microsoft Teams dhe qasjen në pakon Office 365 desktop. Duke përdorur

Shkollat.org, mësuesit dhe nxënësit mund të komunikojnë, të ndajnë dhe të angazhohen me përmbajtjen, të bashkëpunojnë në projekte ekipe ose të krijojnë kuize dhe vlerësime të individualizuara. Zhvillimi dhe zgjerimi i përdorimit të Shkollat.org është thelbësor për të mbështetur të mësuarit digjital në Kosovë. Për ta bërë këtë, Strategjia e Arsimit të Kosovës (2022–2026) e identifikon nevojën që të punohet në gjashtë fusha (ose shtylla): platformat digjitale të të mësuarit, përmbajtjen, përmirësimin e aftësive të mësuesve dhe mbështetjen e tyre, lidhjen me internet, pajisjet dhe mbështetjen institucionale.

Rezultatet në këtë raport janë nxjerrë nga analiza e një vlerësimi të nevojave i realizuar përmes metodave të kombinuara të hulumtimit nga Instituti i Psikologjisë (Universiteti i Prishtinës) dhe i mbështetur nga UNICEF-i në Kosovë në periudhën janar-shkurt 2022. Ky raport hulumtues paraqet mësimet kyçe të nxjerra për politika nga MASHTI dhe politikëbërësit e tjerë të arsimit në Ballkanin Perëndimor. Këto janë të organizuara rreth gjashtë shtyllave të të mësuarit digjital të përfshira në Strategjinë e Arsimit të Kosovës (2022–2026):

1. Platformat digjitale të të mësuarit:

Përpjekjet për të zgjeruar komunikimin, avokimin dhe koordinimin për të pozicionuar Shkollat.org si zgjidhje e të mësuarit digjital që mund të përdoret nga mësuesit për të mbështetur të mësuarit me nxënësin në qendër brenda dhe jashtë klasës fizike. Në Kosovë, mësuesit janë të familjarizuar me mjetet e video-konferencave, siç është Zoom-i, i cili u bë i njohur si rezultat i pandemisë COVID-19. Megjithatë, zgjidhjet e të mësuarit digjital që kombino-

1 Të gjitha referencat për Kosovën duhet të kuptohen duke iu referuar Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
2 Pasaporta e të nxënësve është një platformë online, mobile dhe offline e ofruar nga UNICEF-i dhe e mundësuar nga Microsoft Community Training.

jnë përmbajtjen digjitale me mjetet digjitale ende nuk shfrytëzohen gjerësisht. Për të zgjeruar përdorimin e Shkollat.org si në mjedise në distancë ashtu edhe në një qasje të kombinuar në klasë fizike, ekziston nevoja për t'i integruar mësimdhënësit përmes avokimit, komunikimit dhe përpjekjeve për trajnim. Kjo përfshin inkurajimin e të gjitha drejtorive komunale të arsimit dhe drejtorëve të shkollave për të miratuar dhe promovuar përdorimin e Shkollat.org, duke lehtësuar procesin e integrit të mësimdhënësve dhe duke ofruar mbështetje të mjaftueshme për përdoruesit e rinj.

2. Përmbajtja:

Prioritizimi i zhvillimit të përmbajtjes digjitale cilësore për Shkollat.org, duke përfshirë në proces mësimdhënësit dhe nxënësit. Më shumë se gjysma e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim (62 përqind) raportojnë se kanë kërkuar në internet për përmbajtje edukative. Megjithatë, mësimdhënësit shpesh raportojnë se kur shfletojnë internetin përbalen me sfida për të gjetur përmbajtje digjitale cilësore të përshtatur me kurrikulën. Zhvillimi i përmbajtjes cilësore digjitale shtesë për Shkollat.org dhe promovimi i përdorimit të saj si një repozitor (depo) qendrorë e përmbajtjeve të përshtatura me kurrikulën do të siguronte që mësimdhënësit të kenë qasje dhe të përdorin lehtësisht përmbajtje digjitale të ndryshme për t'u përshtatur qëllimeve të tyre të mësimdhënies. Përmbajtja digjitale cilësore është fleksibël, e qasshme dhe përfshirëse për nxënës të ndryshëm. Ajo ndjek qëllimet e kurrikulës në mënyrë të strukturuar dhe mund të përfshihet lehtësisht nga mësimdhënësit në planet e tyre të mësimdhënies. Qasjet pjesëmarrëse që përfshijnë mësimdhënësit dhe nxënësit në procesin e zhvillimit të përmbajtjes mund të ndihmojnë për të siguruar që përmbajtja digjitale të jetë e rëndësishme dhe motivuese si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit.

3. Përmirësimi i aftësive të mësimdhënësve dhe mbështetja e tyre:

Zhvillimi i programeve të strukturuar dhe cilësore për trajnimin e mësimdhënësve gjatë shkollës që të zhvillohen sipas ritmit dhe nevojave të tyre të mësuarit. Mësimdhënësit në Kosovë shpesh mund të gjejnë mundësi për trajnimin e mësimdhënësve në lidhje me të mësuarit digjital. Megjithatë, programet për trajnim të mësimdhënësve mund të kenë shkallë të ndryshme të cilësisë nëpër komuna dhe shkolla, dhe jo gjithmonë u përgjigjen nevojave të të mësuarit të mësimdhënësve. Standardet e mësimdhënësve për të mësuarit digjital mund të ofrojnë një kornizë për zhvillimin e një kurrikule të strukturuar mbi të mësuarit digjital, që përfshinë nga aftësitë themelore deri në kompetencat e avancuara për të mësuarit digjital përmes përdorimit të Shkollat.org, përfshirë mënyrën e përdorimit të platformës me materiale të tjera në një qasje të kombinuar në klasë. Përveç kësaj, zhvillimi i standardeve për programet e zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe nxitja e trajnimeve të centralizuara digjitale të mësimdhënësve përmes Shkollat.org mund të ndihmojë

në standardizimin e cilësisë së programeve të trajnimit të mësimdhënësve nëpër komuna.

4. Lidhja e internetit (Konektiviteti):

Forcimi i infrastrukturës së lidhjes në internet (konektivitetit) në shkolla (nëpër klasa) dhe zhvillimi i udhëzimeve të praktikave më të mira për menaxhimin e teknologjisë në klasë. Përderisa shumica e shkollave në Kosovë kanë ndonjë mënyrë të qasjes në internet, kjo shpesh nuk përdoret për të mësuarit digjital. Duhet të bëhen përpjekje për të përmirësuar jo vetëm numrin e shkollave të lidhura me internetin, por edhe për të përmirësuar cilësinë dhe shtrirjen e kësaj lidhjeje.

5. Pajisjet:

Zgjerimi i qasjes në pajisjet digjitale, veçanërisht në mesin e nxënësve nga grupet e cenueshme. Si pjesë e Strategjisë së Arsimit në Kosovë (2022–2026), MASHTI ka ndarë burime financiare për të ngritur kapacitetet e TIK-ut në shkolla. Përveç kësaj, MASHTI është duke bashkëpunuar me UNICEF-in në Kosovë që të zhvilloj Formularët e Kërkesave për Pajisje Digjitale, që do të plotësohen nga drejtoritë komunale të arsimit për të kërkuar pajisje digjitale për shkollat e tyre. Në këtë proces, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shkollave me kapacitet më të dobët të TIK-ut në krahasim me numrin e nxënësve. Në shtëpi, ndarja e pajisjeve dhe mungesa e qasjes në internet vazhdojnë të përbëjnë barriera për nxënësit që të angazhohen në mënyrë efektive me të mësuarit digjital. Si rezultat i kësaj, mbështetja e nxënësve nga grupet e cenueshme me pajisje digjitale që të angazhohen në të mësuarit digjital brenda dhe jashtë shkollës duhet të mbetet gjithashtu prioritet.

6. Mbështetja institucionale:

Koordinimi dhe monitorimi i përpjekjeve të digjitalizimit për zbatim të suksesshëm. Strategjia e Arsimit të Kosovës (2022–2026) ofron një dritare për modernizimin e arsimit në Kosovë përmes të mësuarit digjital. Për të siguruar zbatimin e suksesshëm, është e rëndësishme të krijohet një udhërrëfyes për zbatim me caqe të qarta dhe piketa të progresit, të informuar nga të dhënat e gjendjes fillestare dhe ato të monitorimit. Kjo do të mundësonte përcjelljen e zbatimit nëpër komuna të ndryshme dhe do lehtësonte identifikimin e nevojave për mbështetje kur ato lindin. Po ashtu, prioritizimi i krijimit të një njësie të digjitalizimit brenda Kosovës dhe emërimi i koordinatorëve të të mësuarit digjital brenda drejtorive komunale të arsimit dhe shkollave mund të ndihmojë në përmirësimin e koordinimit të përpjekjeve të të mësuarit digjital në Kosovë, duke përfshirë programet e trajnimit të mësimdhënësve dhe shpërndarjen e burimeve të TIK-ut. Komunikimi i vazhdueshëm me mësimdhënësit dhe prindërit do të ishte i rëndësishëm edhe për të koordinuar përpjekjet, rritur pëlqimin dhe motivimin e tyre për të përvetësuar të mësuarit digjital dhe të kombinuar dhe për t'i mbajtur ata të informuar me rritje në këtë fushë, duke përfshirë zhvillimet në Shkollat.org dhe programet e trajnimit.

për çdo fëmijë, përgjigjet

UNICEF Innocenti – Global Office of Research and Foresight
Via degli Alfani, 58
50121 Florence, Italy

Tel: (+39) 055 20 330
Fax: (+39) 055 2033 220
researchpublications@unicef.org
www.unicef-irc.org

@UNICEFInnocenti on Twitter, LinkedIn,
Facebook, Instagram and YouTube

© 2023 United Nations Children's Fund (UNICEF)



Funded by
the European Union

unicef 
for every child